



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT  
OPŠTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Bazuar në dispozitat e nenit 12 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 20 par.20.1 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15 Nr.110-78095 të datës 24.12.2021, nenit 2 paragrafi 4 dhe neni 9 të Rregullores për ndarjen e subvencioneve 15Nr.011-43473 të datës 28.06.2019 , Rregullores së Kuvendit të Komunës me Nr.15-110/04-11057 e datës 28.02.2023 Për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores për Ndarjen e Subvencioneve 15Nr.-011-43473 e datës 28.06.2019, si dhe Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023 , Kuvendi i Komunës në mbledhjen e vet të mbajtur me 28.04.2023, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës mori këtë:

## V E N D I M PËR NDARJEN E MJETEVE FINANCIARE

### Neni 1

I.MIRATOHET, Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në shumën e përgjithshme prej 29.918.00 € (njëzet e nëntë mijë e nëntëqind e tetëmbëdhjetë euro), konform Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023, përkatësisht ;

- a. 23,332,00 euro (njëzet e tremijë e treqind e tridhjetë e dy euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit me serra bujqësore si dhe
- b. 6,586.00 euro ( gjashtë mijë e pesëqind e tetëdhjetë e gjashtë euro) me destinim për subvencionimin –e familjeve me kushte të rënda ekonomike në Komunën e Lipjanit me mekanizëm bujqësor ( frezë për traktor, kosë për traktorë ) si dhe në fushën e blegtorisë ( lope qumështore dhe kope delesh).

II. Ndarja e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi bëhet me qëllim të përmbushjes së obligimeve që rrjedhin nga dispozitat e Memorandumit të Bashkëpunimit dhe Bashkëfinancimit 1-400/01-23123 të datës 10.05.2022 e lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" , Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 24.11.2022 dhe Aneks Marrëveshjes së lidhur në mes të Komunës së Lipjanit dhe Organizatës "QATAR CHARITY" të datës 13.04.2023

III. Shuma e mjeteve të cekura në pikën I të këtij Vendimi do të ndahet nga buxheti i Komunës , kodi i programit 47003, kategoria ekonomike e subvencioneve të planifikuara për vitin 2023 për Drejtoratin për Bujqësi dhe Pylltari.

IV.Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

V. Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës

Nr. 15-400/01-22359

Lipjan, më 28.04.2023

**KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN**

**Kryesuesi i Kuvendit**

**Daut Azemi**

